

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" ALBANIA WORK" SHPK

Sot me daten 01/08/2024 (dymijë e njëzet e katër), unë ortaku themelues :

- **I Z.GENC DODA**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 19 Janar 1982, lindur në Vakuf dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I20119051N

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " ALBANIA WORK" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " ALBANIA WORK" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Sukth I Ri,ndërtesë me zk.3542, nr pasurie 14/80/ND,vol.18,fq.177,Durrës.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Eksport, import, tregti, dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme, agjensi imobiliare, blerje, shitje,dhënie me qera, ndërmjetësim për shitje dhe blerje të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të llojeve të ndryshme, ndërtesa, aparatamente, toka truall dhe arë, pyje,njësi tregtare, garazhde. Ofrimin e shërbimit të menaxhimit të marrëdhënies me publikun, marketing dixhital nëpërmjet ofrimit të dizenjimit dhe menaxhimit të faqeve të rrjeteve sociale për qëllime marketingu. Shërbime marketing online.Krijim, menaxhim dhe shitje të faqeve website. Çdo gjë që i shërben aktivitetit dhe çdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar. Ndërtimin e çdo lloji godine,sikurse janë pallatet e banimit,ndërtimet civile, industriale, turistike, bujqësore, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parkingje,komplekseve të ndryshme turistike, në zona malore e bregdetare, të depove stacionere për karburante e nënprodukteve të tyre si dhe rikonstruksione të ndryshme ndërtimore, etj. Ndërtimin e urave, çeljen dhe ndërtimin e rrugëve të reja, të autostradave të komunikacionit urban



dhe interurban, asfaltimin e tyre, si brenda vendit dhe jashtë shtetit, kryerjen e veprave të artit dhe mirëmbajtjen si dhe përmirësimin e tyre në përputhje me infrastrukturën bashkëkohore. Kryerjen e punimeve për prodhimin dhe montimin e konstruksioneve metalike të çdo lloji dhe mikse, tregtimin e tyre me shumicë e pakicë, importin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike dhe vënien në shfrytëzim të linjave dhe reparteve për prodhime konstruksioni metalike dhe dhënien e asistencës teknike për to. Punime dhe kanalizime për rrjetet e jashtme dhe të brendshme të ujësjellësve të qendrave të banimit, në qytet, komuna dhe fshatra të çdo rrjeti të sistemit hidrik, sikurse janë ndërtimi dhe kryerja e punimeve përmirësuese të digave, hidrovoreve, në central elektrik TEC-et, hapje dhe shtrirje tubacionesh për rrjedhjen në kanalizime të ujrave të bardhave dhe të zeza duke shmangur çdo ndotje të ambientit dhe mjedisit. Ndërtim të impianteve të pastrimit të mbeturinave civile dhe industriale, kryerje punimesh për ngritjen dhe restaurimin e rrjetit bonifikues të vaditjes dhe kullimit të tokave, të stacioneve të pompimit, përfshirë dhe kryerjen e veprave të artit ndërtimore të tyre. Ngritje dhe vënie në funksionim të poligjoneve të ndërtimit për prodhimin e materialeve inerte, të betoneve, penobetoneve dhe të çdo materiali ndërtimor parafabrikat, si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë, brenda vendit dhe jashtë vendit. Ndërtime mbrojtëse e punime sistemimi kundër grryerjeve lumore, liqenore, detare të rezervuareve pellgmbajtës, kryerje punimesh për gërmime dheu me mjete të mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe përforcimi në to, të prodhimeve pilote dhe elementëve të tjera betonarme, prodhim guri për skolierat në ndërtimet portuale, punime çimentimi dhe të injektiveve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nënujore, etj. Kryerje punimesh në sipërfaqet e gjelbërta, pyje, kullota, parqe, mirëmbajtje dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane dhe pastrim i sipërfaqeve urbane. Import, eksport dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të materialeve të gjithëllojshëm ndërtimorë, të teknologjive dhe mjeteve të mekanizuara për nevojat e ndërtimit, të pajisjeve dhe materialeve hidrosanitare, elektrike, të axhensorëve, dyerve blindate, të prodhimeve prej duralumini e të pjesëve të ndryshme të këmbimit për çdo makineri apo pajisje, si dhe çeljen e reparteve dhe linjave të prodhimit për to, brenda vendit e jashtë shtetit, si vetëm dhe në kooperim dhe bashkëpunim me firma private të huaja. Çeljen dhe ushtrimin e aktivitetit të shërbimit social privat me anë të hoteleve, barrestoranteve si dhe transport ndërkombëtar për pasagjerë dhe të mallrave të çdo lloji me mjetet e veta të komunikacionit ose të të tretëve. Marrjen pjesë në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, në fushën e ndërtimit dhe të teknologjisë bashkëkohore të tij, me qëllim jo vetëm ekspozimin e gamës së prodhimeve ndërtimore të firmës por dhe për të mundësuar arritjen e marrëveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe të huaj për zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit të përbashkët tregtar me to, si dhe pjesëmarrje në tendera brenda e jashtë vendit. Ushtrimi i aktiviteteve juridike, shërbime avokatie, për mbrojtjen e interesave të veta dhe për të tretët, brenda dhe jashtë vendit, si dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit në zbatim të legjislacionit në fuqi. Miratimin dhe zgjerimin e aktiviteteve tregtare me shërbimet e tregtimit me shumicë e pakicë të produkteve bujqesore, fruta - perime etj. Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive të paluajtshme. Shoqëria mund të permbushë të gjitha operacionet tregtare, në fushën e pasurive të paluajtshme, financiare dhe industriale që do të konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ ose të



dobishme per te arritur qellimin e shoqerise, Shoqeria mund te kryejë transaksione financiare, dhe te pasurive te paluajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimit te shoqerise. Te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekt te njejte, te ngjashem apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakëve dhe ne favor te te treteve.

NENI 4 **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "ALBANIA WORK" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

1. GENC DODA zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5 **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë

1- **Z.GENC DODA**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7 **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".



2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKU THEMELUES TË SHOQËRISË
"ALBANIA WORK" SH.P.K

GENC DODA

